

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Paketa e Maleve është për pronarët", Rama flet nga New York: Projekti i Zvërnecit dhe Sazanit sjell 4 mi liardë euro në një ekonomi
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/paketa-e-maleve-eshte-per-pronaret-rama-flet-nga-new-york-projekti-i-i402107
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 19:24:29 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 19:21:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	beb5ea6b6b557116d8ebdd047e9ebdd6d6c1f0c1ae250e8f6f5b40aa7020373d
TEKSTI	93923c1491cddc7a90cecae5497f16f69fa7858ede436f6cd2ba11757c94d1de
PAMJA	e6176ed47743e7c324044daadde7a67611cc3998bca89510ddb6b465bf82b374

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8454528af7a7600315ba1cc4015ee24ae43948324a3db261897bde49560a9cce
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	20cb9bc098b6b22129b01f41a10ad3ad7e12cceb89fa0b5f21647847572e06c6
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8454528af7a7600315ba1cc4015ee24ae43948324a3db261897bde49560a9cce>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

[Kreu](#) [Politikë](#) [Aktualitet](#) [Ekonomi](#) [Kulturë & Art](#) [Rajon](#) [Sport](#) [Bota](#) [Showbiz](#) [SocialBomb](#)

Çështjet kryesore

SPAK në gjurmët e shtetarëve të lidhur me Agasin

Haga vendos për katër ish-krerët e UÇK-së!

Arrestohet Ergys Agasi

Aktualitet

26 Shtator 2026, 21:21

"Paketa e Maleve është për pronarët", Rama flet nga New York: Projekti i Zvërnecit dhe Sazanit sjell 4 miliardë euro në një ekonomi

Shkruar nga Newsbomb



Edi Rama

Në takimim me shqiptarët Staten Island të New York, kryeministri Edi Rama ka folur për Paketën e Maleve dhe projektet në Zvërnec dhe Sazan. Rama u shpreh se Paketa e Maleve synon t'u japë mundësi pronarëve të zhvillojnë pronat e tyre, duke theksuar se investorët e tjerë mund të përfshihen vetëm nëse janë partnerë të pronarëve dhe nëse kjo është dëshira e tyre.

Rama u shpreh se kjo nisëm ka për qëllim rritjen e turizmit në Shqipëri, që sipas tij, nga 12 milionë vizitorë, duhet ta çojmë në 20 milionë.

"Kthimi i maleve në një burim mirëqenieje është një burim i rëndësishëm për ta çuar përpara Shqipërinë. Synimi është që nga 12 milionë vizitorë në Shqipëri, është ta çojmë në 20 milionë. Më pas detyra është e të rinjve që do të marrin stafetën që ta çojnë më lart. Tashmë synimi është që në Shqipëri të sjellim turistin me të ardhura të larta," thekson Rama.

Gjithashtu, ai u ndalë gjatë fjalës së tij edhe te projekti për Zvërnecin dhe Sazanin, të cilin e cilësoi si një projekt me rëndësi të madhe ekonomike, që sipas tij, ky projekt do të sjell 4 miliardë euro në një ekonomi

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Rajoni

Erdogan i kundërpërgjigjet Netanyahu pas akuzë për "diktator": Vendi i kriminelëve të luftës është në gjykatë



Sporti

Tifozët bëjnë "detyrën" për Kombëtaren, zbulohet numri "bombastik" i biletave të shitura

Zbulu më shumë artikuj >

"Këtë synim ka edhe projekti i shumëdiskutuar, i famshëm, por edhe famëkeq si rezultati i shumë gënjeshtreve, manipulimeve dhe politik, Zvërneci dhe Sazani. Ky projekt sjell 4 miliardë euro në një ekonomi që në total është 27 miliardë euro," shprehet Rama.

Fjala e Ramës:

Paketa e Maleve është bërë për të gjithë ata që kanë pronën atje dhe asnjë investitor tjetër nuk do të ketë akses nëse nuk është partneri juaj dhe nuk është dëshira juaj për ta pasur atje. Kush dëshiron të ketë një partner, është i mirëseardhur.

Kthimi i maleve në një burim mirëqënieje është një burim i rëndësishëm për ta çuar përpara Shqipërinë. Synimi është që nga 12 milionë vizitorë në Shqipëri, është ta çojmë në 20 milionë. Më pas detyra është e të rinjve që do të marrin stafetën që ta çojnë më lart. Tashmë synimi është që në Shqipëri të sjellim turistin me të ardhura të larta.

Këtë synim ka edhe projekti i shumëdiskutuar, i famshëm, por edhe famëkeq si rezultati i shumë gënjeshtreve, manipulimeve dhe politik, Zvërneci dhe Sazani. Ky projekt sjell 4 miliardë euro në një ekonomi që në total është 27 miliardë euro.

I jashtëzakonshëm për Shqipërinë, por edhe delikat në ekuilibër në mjedisin dhe po punojmë shumë për të studiuar impaktin dhe për të kuptuar risqet reale dhe jo ato që prodhohen në rrjetet sociale nga manipulorët dhe sharlatanët. Ditët e punës këtu kanë pak kafe dhe për më tepër atë kafën e tmerrshme amerikane, ndryshe nga Shqipëria.

Ju falënderoj për kohën që ju mora në këtë ditë pushimi. Falënderoj Xhemon që është veshur si politikan amerikan, unë para teje ngaj si roja i hotelit. Të falënderoj shumë për organizimin. Bashkë me ty janë edhe disa djem nga Ulqini, shumë faleminderit.

Nëse burrat e Shqipërisë kanë bërë shumë budallallëqe, imagjino ç'do të bënin po të mos kishin gratë, prandaj ju falënderoj edhe juve. Mbajini mirë burrat dhe mos ja vini veshin kur bëjnë si të fortë, sepse në zemër dridhen kur flisni ju.

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Shtunë 20:59

"U prita me një tortë rozë dhe dy flamingo", Rama flet nga SHBA-ja: Një nga hedhësit e vezëve kishte ardhur nga Britania për mua





Aktualitet

Mbyllen hetimet për vrasjen e gjyqtarit Astrit Kalaja, shkodrani Elvis Shkambi shpallet FAJTOR

E Shtunë 20:34



Aktualitet

Si në filmat aksion: Të rinjtë me "Audi" Q7 nuk iu binden Policisë për të ndaluar, përplasen me makinën e patrullës

E Shtunë 18:49



E Shtunë 17:56

I jep fund jetës i dënuari në burgun e Reçit, pasi vrau gruan familjarët "e braktisën", asnjë takim që nga 2025 (EMRI-DETAJE)



Aktualitet

Plagosja e 10-vjeçares shqiptare në Athinë, DETAJE: Urdhrin për atentat ndaj lokalit të Denis Lullit e dha "Mafia e Burgjeve"

E Shtunë 17:49 Newsbomb



Aktualitet

Panik në autostradën Tiranë-Elbasan, autobusi i pasagjerëve përfshihet nga flakët

E Shtunë 17:26



E Shtunë 16:54 Newsbomb

RRËQETHËSE: Çifti shqiptar që vdiqën në Athinë ishin në pritje të fëmijës së tyre të parë, Florida Hoxha një avokate e zonja, FLET mikeshja



Aktualitet

Aksidenti i frikshëm pranë Sukthit, "Volkswagen"-i përmbysët në mes të autostradës


E Shtunë 15:57



Aktualitet

Nga Tirana në Korçë, 43 restorantet dhe hotelet që u furnizuan me djathë të helmuar, kompania "INITALY RISTO&GUSTO" ia hodhi me një gjobë (INVESTIGIMI)

E Shtunë 15:20



E Shtunë 15:21 Newsbomb

ISP zbulon sukseset dhe kritikët ndaj ambasadorët amerikanë të Shqipërisë që janë emëruar gjatë 35 viteve (LISTA)



Aktualitet

Po rregullonte pompën e varkës dhe ra në kontakt me rrymën elektrike, 28-vjeçari VDES në duart e mjekëve të Durrësit

E Shtunë 15:02 Newsbomb



Aktualitet

Shijaku vlerëson kontributin e agronomit që i shërbeu brezave të tërë, emri i ENVER DUKES skalitet në një prej rrugëve të qytetit

E Shtunë 14:54



Aktualitet



🕒 E Shtunë 14:50 Newsbomb

29-vjeçari me “Toyota” merr përpara këmbësorin në vijat e bardha, nisat me

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.